



RAPORTI VJETOR MBI DHENDJEN E FILANTROPISE  
FAKTE TË SHPEJTA

10.7%  
MITROVICË

4.4%  
PEJË

12.8%  
GJAKOVË

13.1%  
PRIZREN

42.7%  
PRISHTINË

7.6%  
GJILAN

3.5%  
FERIZAJ

Shpërndarja gjeografike

3.2%  
NË TËRË KOSOVËN

2.0%  
JASHTË KOSOVËS



344

numri i rasteve të regjistruara



1.9 milion €

vlera totale e regjistruar e donacioneve



1.0€

mesatarja e donacionit për qytetar



43.7%

rënie nga viti 2017

# Shënimet hyrëse

Me të gjeturat e studimit tonë të prezantuara këtu, është e rëndësishme t'u kushtojmë vëmendje rrethanave në prapaskenën e grumbullimit të të dhënave lidhur me filantropinë në vitin 2018. Këtë vit, më shumë se në vitet e kaluara, Catalyst Balkans përballej me mungesën e të dhënave të mjaftueshme për Kosovën.

Së pari, raportimi për filantropinë në Kosovë në përgjithësi, për sa i përket numrit të raporteve në media, këtë vit është zvogëluar në krahasim me vitin 2017. Publikimi i informacioneve relevante në raportet e mediave (të cilat paraqesin burimin tonë kryesor të informatave) ka qenë poashtu i ulët, në shumë raste janë ofruar informata jo të plota dhe të pa aplikueshme, disa herë edhe shumë vështirë për t'u shfrytëzuar në mënyrë efektive. Së dyti, të dhënat nga burimet direkte – të cilat i përdorim për të verifikuar informacionet – nuk ishin gjithmonë transparente, të gatshme ose të lehta për t'u qasur; donatorët dhe pranuesit e donacioneve nuk ishin plotësisht të hapur dhe të gatshëm të shkëmbejnë informacione. Dhe së fundi, megjithëse transparenca mediatike sa i përket vlerave të dhuruara ka pësuar një ulje të vogël, raportimi më i rrallë dhe me kualitet më të ulët përfundimisht ka ndikuar në vlerat e dhuruara dhe ka reflektuar në vlerat që kanë rezultuar në kalkulimin final të donacioneve, në mënyrë që të shprehen vlera të konsiderueshme më të ulëta se viti i kaluar.

Duke marrë parasysh këta faktorë, Catalyst Balkans do të vazhdojë të vëzhgojë nga afër trendet e zhvillimit të filantropisë në Kosovë si dhe trendet e raportimit në media lidhur me temën, por gjithashtu do të bëjë përpjekje shtesë për të kërkuar dhe siguruar informacione më thelbësore lidhur me dhënien filantropike.

# Metodologjia

Ky raport është përgatitur duke përdorur bazën e të dhënave Giving Ballkans i cili mbetet burimi më i besueshëm i të dhënave mbi dhënien e bamirësisë në rajon. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, Catalyst Balkans shfrytëzon mënyra alternative për të grumbulluar të dhëna, kryesisht raporte të mediave dhe burime të tjera të gatshme. Raportet e mediave janë mbledhur duke ndjekur mediat elektronike, të shtypura dhe online në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar në Kosovë në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2018. Në këtë periudhë, gjithsej 2,203 raste në lidhje me dhënien e bamirësisë nga të gjitha llojet e donatorëve u përpunuan në bazën e të dhënave Giving Ballkan, nga të cilat 344 ishin raste unike.

Kjo metodologji ka disa kufizime, duke përfshirë faktin më të rëndësishëm se mediat nuk i regjistrojnë të gjitha rastet e dhënies së bamirësisë. Megjithatë, ne besojmë se hulumtimi ynë siguron një pasqyrë mjaft të besueshme të aspekteve më të rëndësishme të dhënies së bamirësisë, sepse, shifrat, megjithëse nuk janë gjithëpërfshirëse, ofrojnë një vlerë minimale për treguesit përkatës. Nëse, për shembull, diskutojmë numrin e rasteve të bamirësisë, mund të themi me siguri se numri që tregojmë është numri minimal i rasteve që kanë ndodhur. E njëjta gjë është e vërtetë për shumat e parave të gatshme, aktorët dhe të ngjashme. Prandaj, këto të dhëna mund të përdoren si tregues të shkallës minimale të zhvillimit të filantropisë në Kosovë.

# Pikat kyçe

## Niveli i dhënies

Në krahasim me vitin e kaluar, vlera totale e donacioneve ka pësuar rënie të konsiderueshme, për 43.7% - rreth 1.9 milion EUR janë donuar në Kosovë në vitin 2018. Rënia është e dukshme në të gjitha aspektet: vlera totale e regjistruar e donacioneve është zvogëluar me më shumë se 50%, përderisa edhe aktiviteti pësoi rënie – gjithsej 344 raste unike të dhënies së bamirësisë janë regjistruar në vitin 2018.

## Shpërndarja gjeografike

Edhe pse pati një rënie në përqindjen e rasteve të donacionit, Rajoni i Prishtinës mbetet si rajoni më i përkrahur (42.7%). Sa i përket shpërndarjes në rajone të tjera, Gjakova dhe Prizreni patën një rritje në shpeshësinë e mbështetjes, përderisa Mitrovica dhe Peja vijojnë me nivelin e ruajtur nga viti 2017. Nga ana tjetër, Ferizaj dhe Gjilani patën një rënie. Përfundimisht, numri i rasteve të donacionit në më shumë rajone në shtet dhe jashtë Kosovës mbeten në nivelin e njejtë nga viti 2017. Për sa i përket qyteteve, 35.6% të rasteve të donacionit janë drejtuar Prishtinës, duke i vendosur donacionet për *kryeqytetin* në majë.

## Donatorët

Donatorët individual mbeten si lloji më i shpeshtë i donatorëve këtë vit me një aktivitet të zvogëluar në krahasim me vitin 2017: 32.8% të rasteve të donacionit. Qytetarët gjithashtu ishin më pak aktiv dhe mbeten në vendin e dytë (31.4%), përderisa sektori korporativ e përforcoi aktivitetin dhe mori pjesë në 17.7% të rasteve të donacionit. Sa i përket *vlerës së donacioneve* të regjistruara, qytetarët ishin më bujarët – duke marrë pjesë në fushata të mëdha të organizuara dhe të strukturuar, ata në mënyrë të konsiderueshme e rritën pjesëmarrjen e tyre në vlerën e regjistruar në 61.6%. Të dhënat për donatorët individual si dhe për sektorin korporativ tregojnë se vlerat e dhuruara janë zvogëluar. Kontributi i Diasporës poashtu është zvogëluar këtë vit, si në aspekt të aktivitetit ashtu edhe në vlerat e dhuruara.

## Temat

Dy tema kyçe janë mbështetur këtë vit në mënyrë të barabartë me 25.9% të rasteve secila: lehtësimi i varfërisë (megjithëse me një rënie të vogël por duke ruajtur pozitën nga viti 2017) dhe shëndetësia, e cila mori një përqindje dukshëm më të lartë të rasteve të donacioneve krahas viteve të kaluara. Në krahasim me vitin 2017 interesi në arsim gjithashtu pati një rritje të konsiderueshme (21.8%), përderisa mbështetja e grupeve të marginalizuara pësoi zvogëlim.

## Pranuesit

Pranuesit më të shpeshtë kanë qenë individët dhe familjet me një rënie të vogël por sërish të konsiderueshme me 57.8% të rasteve. Me një rënie të vogël në numrin e rasteve të drejtuara kah ato, organizatat jo fitimprurëse qëndruan në vendin e dytë. Institucionet, qeveritë lokale dhe

nacionale vijnë dhe kanë patur një rritje në shpeshësinë e mbështetjes, dhe rrjedhimisht interesi në *mbështetjen e shtetit* (institucionet, qeveritë lokale dhe nacionale) është rritur në 20.6% në vitin 2018 sa i përket numrit të rasteve.

### **Organizatat jo fitimprurëse**

Shoqatat e vendit dhe fondacionet private morën një të pestën e të gjitha rasteve të donacionit në vitin 2018 (19.8% raste të regjistruara) që shpreh një rënie të vogël kur e krahasojmë me vitin e kaluar. Duke vazhduar trendin e vitit të kaluar, donatorët më aktiv për organizatat jo fitimprurëse kanë qenë qytetarët, edhe pse interesi si prej qytetarëve ashtu edhe prej donatorëve individual ka pësuar rënie. Si donator, sektori korporativ vazhdoi të mbështes organizatat jo fitimprurëse në shkallë të njëjtë në vitin 2018, i cili mund të jetë një tregues i një trendi të ardhshëm pozitiv dhe një përfshirje aktive të kompanive në mbështetjen dhe partneritetin me organizatat jo fitimprurëse.

### **Përdorimi i donacioneve**

Të dhënat tregojnë se interesi i donatorëve për dhëniet strategjike është rritur dukshëm. Në krahasim me nivelin e vitit 2017, investimet afatgjate treguan një ndryshim pozitiv duke përbërë 35.5% në vitin 2018. Kjo rritje ndikohet veçanërisht nga investimet në paisje për shëndetësi dhe mbështetje për bursa. Donacionet e një-herëshme patën një rënie në përqindje, por prapë se prapë morën më shumë se gjysmën e të gjitha rasteve të donacionit me 56%.

### **Përfituesit**

Edhe pse përqindja e rasteve të donacionit për njerëz me nevoja ekonomike është zvogëluar këtë vit, ky grup përfituesish mori mbështetjen më të madhe prej 30.8%. Interesi për komunitete lokale, njerëz me probleme shëndetësore dhe njerëz me aftësi të kufizuara është rritur nga viti i kaluar. Shumica e grupeve të përfituesve përfundimtar akoma janë të mbështetur në një masë më të vogël, megjithatë këtë vit lista është pakësuar për disa kategori.


### **Transparenca e të dhënave**

Pas disa viteve me tendenca pozitive, në vitin 2018 një përqindje pak më e ulët (51.7%) në rastet e donacionit, u regjistrua një vlerë e lidhur me ta. Pasi kjo rënie ishte vetëm 1.8%, ne besojmë se është vetëm një luhajtje një vjeçare sesa një trend i ri i përhershëm.

Në përgjithësi, në vitin 2018 në Kosovë, më aktivë kanë qenë donatorët individual. Sektori Korporativ e përforcoi aktivitetin, përderisa qytrarët ishin ato më bujarët. Nevoja në rritje për ndihmë në shëndetësi dhe aftësinë e donatorëve për të adresuar këtë çështje me më shumë mbështetje dhe gjithashtu një pjesë e shtuar e rasteve të donacionit të dedikuara për arsimin rriti shpeshësinë e mbështetjes për institucionet dhe vetë shtetin. Megjithatë, përkundër rënies së mbështetjes, situata e përgjithshme socio-ekonomike ruajti lehtësimin e varfërisë dhe njerëzit me nevoja ekonomike në qendër të vëmendjes së donatorëve këtë vit.

# Donatorët

## Donacionet sipas llojit të donatorëve



## Trendet kryesore në llojet e donatorëve – 2016 deri 2018

% e rasteve	2016		2017		2018
Publiku i gjere	45.3%	↘	33.5%	↘	31.4%
Sektori i biznesit	16.2%	↘	13.0%	↗	17.7%
Individët	28.1%	↗	38.3%	↘	32.8%
% e vlerës së regjistruar	2016		2017		2018
Publiku i gjere	34.5%	↗	36.6%	↗	61.6%
Sektori i biznesit	11.1%	↗	24.3%	↘	6.5%
Individët	22.8%	↘	8.9%	↘	4.3%

## Pikat kyçe

Në vitin 2018, në Kosovë, numri i rasteve të regjistruara të donacionit pati një rënie në krahasim me vitin e kaluar - 344. Vlera totale e donacioneve raportuar nga mediat dhe e cila mund të verifikohet edhe nga burime të tjera është dukshëm më e ulët se ajo në vitin 2017 – është pak më shumë se 1.4 milion EUR. Studimi ynë i kujdesshëm na solli deri tek konkluzioni se vlera e llogaritur e donacioneve për qëllime bamirëse në Kosovë në vitin 2018 ka qenë pak më shumë se 1.9 milion EUR.


Sa i përket aktivitetit, edhe këtë vit është hasur një pamje e ngjashme e donatorëve si në vitin 2017. Që dmth se donatorët individual, janë lloji më i shpeshtë i donatorëve dhe qytetarët përmes dhënieve në masën individuale kanë zënë një pjesë të konsiderueshme në sasinë e donacioneve - 32.8% dhe 31.4% përkatësisht. Megjithatë, të dy llojet e donatorëve kanë parë një rënie të aktivitetit që nga viti i kaluar. Vlen të theksohet se mbi 63% të të gjitha rasteve të donacionit nga donatorët individual në fakt janë dhënie nga diaspora. Sa i përket sektorit korporativ, i cili e ka rritur aktivitetin e tij dhe ka marrë pjesë me 17.7% nga rastet e regjistruara të donacionit.

Duke parë vlerat e dhuruara viti 2018 shënohet me pjesëmarrjen e lartë të qytetarëve në numrin total të shumave të regjistruara, me një rritje mbesëlënëse prej 61.6%. Edhe pse pak më pak aktiv këtë vit, qytetarët reagojnë me bujarë ndaj disa fushatave dhe iniciativave të organizuara nga disa organizata jo fitimprurëse, të cilat kryesisht punuan për mobilizimin e komunitetit për mbështetjen e shëndetësisë dhe për të ofruar ndihmë në lehtësimin e varfërisë me raste të ndihmave humanitare dhe strehim të individëve. Përpyekjet më të mira të strukturuar dhe të përqendruara të mbledhjes së fondeve treguan potencialin dhe aftësinë e qytetarëve për të ndihmuar kur është e nevojshme më së shumti. Pjesëmarrja e sektorit korporativ në vlerat e dhuruara ka rënë në vetëm 6.5% në vitin 2018; ndryshe nga viti i kaluar, nuk janë regjistruar donacione nga korporatat me vlerë të konsiderueshme, por të dhënat tregojnë se një pjesë e mbështetjes monetare që vjen nga sektori korporativ bën pjesë në dhëniet nga donatorë të përzier, ndërsa donatorët e përzier vijnë me një pjesëmarrje të rritur prej 18.1% nga vlera e regjistruar.


Donatorët nga diaspora janë paraqitur me 35.5% nga të gjitha rastet e donacionit dhe and përbëjnë 18.6% të vlerës së alokuar në 2018. Në krahasim me vitin 2017 kjo shpreh një rënie, megjithëse numrat rrotullohen në një shpërndarje mesatare përgjatë viteve.

# Profilet e llojeve më të shpeshta të donatorëve: Sektori i biznesit


## Top 3 subjektet pranuese



## Top 3 temat e dhënies



## Top 3 grupet e përfituesve përfundimtarë



## Shembuj të dhënieve nga sektori i korporatave

Në përgjithësi, bankat treguan një aktivitet të konsiderueshëm këtë vit. Përveç donacioneve të bëra për fondacionin "Ti je një Luledielli", në dhjetor të vitit 2018 Banka NLB dhuroi EUR 13,000 për Institutin Special Psikiatrik në Shtime, me qëllim që të kontribuojë në rinovimin e njesisë së institutit.

Raiffeisen Bank, që fitoi çmimin FIDES për kontribut kombëtar "Hasan Prishtina" 2017, nga Forumi për Inicjativa Qytetare (FIQ) Kosovë, i ka dedikuar fondet e saj për departamentet e neonatologjisë të spitaleve në zona të ndryshme. Në bashkëpunim me shoqatën "Të veprojme



për Nënat dhe Fëmijët”, Raiffeisen Bank dhuroi një makinë ultratingull në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, dhe një pajisje për monitorimin e bilirubinës në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Si plotësues i kësaj, Raiffeisen gjithashtu hapi një qendër informative ku mbaheshin orë për nënat e reja në komunën e Dragashit si dhe mbështeti financiarisht shitoren TeshaVesha – mekanizmi kryesor për financimin e “Të veprojme për Nënat dhe Fëmijët” në Ferizaj.

Fëmijët gjithashtu ishin një nga motivuesit e partneriteteve të përgjithshme mes korporatave dhe organizatave jo fitimprurëse, që vazhduan këtë vit me disa fushata të rëndësishme. Një nismë e rëndësishme, “Ne qëndrojmë me Fëmijët”, paraqet mbështetjen e Telekomunikacioneve IPKO me pesë qendra të burimeve dhe pesë organizata të ndryshme që ndihmojnë fëmijët me nevoja të veçanta. IPKO i dhuroi EUR 1,000 secilës organizatë – ndër të tjera, Qendra e burimeve për fëmijët me pengesë intelektuale “Përparimi” në Prishtina, “Nënë Tereza” në Mitrovicë, “Shoqata AUTIZMI” në Lipjan, dhe organizata HANDIKOS në Suharekë – me qëllim që kjo të jetë cikli i parë i mbështetjes për të mbuluar nevojat e ndryshme të përfituesve dhe komuniteteve të ndryshme. Një fushatë tjetër paraqiti grupin Elkos, i cili u dakordua me Fshatrat e fëmijëve SOS në Kosovë të donojnë të mira materiale në vlerë EUR 6,000, e cila konvertohet në formë ushqimi dhe furnizime tjera në vlerë prej EUR 500 në bazë mujore.

Si pjesë e një fushate rajonale e cila ishte e organizuar edhe në Shqipëri dhe Maqedoni dhe e udhëhequr nga fondacioni “Ti je një Luledielli” në Kosovë, Kompania Kujtesa, ofruesi lokal i telekomunikacioneve dhe internetit, i është bashkuar fushatës duke blerë 739 bluza të tyre në çmim prej EUR 20 secilën. Banka NLB investoi në nismën e njejtë më herët vitin e njejtë në muajin Mars, duke ndarë fonde për 500 bluza. Fondet do të ndihmojnë më vonë Departamentin e Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë për të blerë pajisje të nevojshme.

Kompanitë gjithashtu e kanë përqëndruar mbështetjen e tyre ndaj njerëzve me nevoja ekonomike. Sigurimi i strehimit përbënte një pjesë të madhe të mbështetjes për këtë grup përfitues në vitin 2018, në shembuj nga Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme si BAU-ING dhe “AR Katana”, por gjithashtu edhe korporata si Z-Mobile dhe Bucaj Kompani që ndihmuan duke investuar dhe ndërtuar ose rindërtuar shtëpi për familje në nevojë. Kryesisht për komunitete lokale në Kosovë, ata që humbën shtëpitë e tyre në përmytjet e Suharekës në Gusht kanë marrë ndihmë nga bizneset lokale në vlerë totale prej EUR 5,000.


Çmimi FIDES për Kontributin e Korporatave të vitit 2018 në nivel kombëtar, të themeluara nga Forumi për Inicjativa Qytetare (FIQ)

Kosovë, shkoi për Meridian Express. Kjo kompani ka dëshmuar një përkushtim gjatë gjithë vitit për të ndihmuar komunitetin përmes biznesit të përgjegjshëm dhe kontributeve për grupe të ndryshme përfituese. Në mars të vitit 2018, Meridian Express organizoi një fushatë me emrin "Kontriboni për fëmijët, bleni produktet e Stafit" dhe gjeneroi 10% të çdo produkti nga Stafit të cilat kompania i ndau për shoqatën "Të veprojme për Nënën dhe Fëmijët" me qëllim të përkrahjes së punës së tyre, e cila kryesisht është e përqëndruar në shëndetësi. Përveç kësaj, Meridian Express mundësoi asistencën e vullnetarëve në disa projekte mjedisore, siguroi mbështetje humanitare aty ku duhej më shumë dhe furnizime gjatë rasteve të veçanta sezonale.


Si në rastin e bankave, fëmijët ishin motivuesit për NVM-të. Si për shembull, Agjensioni për Financim në Kosovë (AFK) donoi lojëra dhe libra në vlerë prej EUR 500 për një çerdhe në Malishevë e quajtur "Zërat e Ëmbël." Ndër dhuratat e tjera, kompania Bora prezantoi një donacion monetar për fëmijën e parë të lindur në 2018, ndërsa siguroi edhe pelena në Klinikën Universitare në Shkup, Maqedoni. Kompania "Al Trade Center" e motivuar nga festat në fund të Dhjetorit i'u shpërndau dhurata fëmijëve pa përkujdes prindëror.

# Profilet e llojeve më të shpeshta të donatorëve: Publiku i gjere


## Top 3 subjektet pranuese



## Top 3 temat e dhënies



## Top 3 grupet e përfituesve përfundimtarë



## Shembuj nga dhënia e masës individuale

Këtë vit janë paraqitur shembuj të ndryshëm të filantropisë të udhëhequra nga qytetarët në Kosovë. Qytetarët këtë vit kanë qenë më aktiv në reagimin ndaj thirrjeve të ndryshme dhe pjesëmarrjen në fushata për mbledhjen e fondeve të organizuara nga organizata jo fitimprurëse të ndryshme. Në këtë mënyrë janë plotësuar kryesisht nevojat e domosdoshme të njerëzve me nevoja ekonomike dhe njerëzve me probleme shëndetësore; fushatat për mbledhjen e fondeve ishin të shumta dhe grumbulluan shuma të mëdha monetare të cilat gati e dyfishuan pjesëmarrjen e qytetarëve në vlerën e regjistruar të donacioneve për vitin 2018.

Organizata Jetimët e Ballkanit dedikoi punën e saj për të ndihmuar njerëzit me nevojë për strehim të menjëhershëm. Në vitin 2018 ato

arritën të grumbullojnë rreth EUR 380,000 nga qytetarët dhe diaspora e Kosovës dhe ndihmuan duke ndërtuar shtëpi dhe akomoduar njerëz të pastrehë në vend.

Megjithatë, një iniciativë është unike për nga motivi i saj. Uta Ibrahim, gruaja e parë nga Kosova që është ngjitur në malet e Himalajës, organizoi një fushatë për grumbullimin e fondeve për sigurimin e tarifës për pjesmarrjen në ngjitjen e ardhme në Himalaje në Lochte dhe Kanchenjunga. Falë iniciativës të shumë qytetarëve përkrahës, Uta arriti të grumbullojë EUR 9,000 për tarifën e pjesëmarrjes dhe pushtoi 14 maja të Himalajave si rezultat

Një tjetër fushatë solidariteti paraqiti “Kampin e super vullnetarëve” të organizuar nga OJQ TOKA, ku vullnetarët e dedikuan kohën e tyre për të ndërtuar rafta librash për shkollën fillore “Iliria” në Prishtinë. Fushata shumë-vjeçare që prëfshiu kampin e “super vullnetarëve” që punonin në ndërtimin e gjërave, është mbështetur nga Organizata të ndryshme qytetare lokale si dhe OJQ internacionale ndër vite, madje duke arritur edhe në Zelandën e Re.

Projektet e rikonstruktimit në komunitet përsëri kanë qenë të spikatura në rajon; një projekt i tillë në Kosovë u përqëndrua në rikonstruktimin e një të një kinemaje të dashur nga shumë. Kinemaja historike “Jusuf Gervalla” në Pejë ishte në gjendje jo të mirë edhe krahas së mirëmbajtjes nga ana e OJQ “Anibar.” Duke u përballur me shpenzimet e mirëmbajtjes në rritje, qytetarët dhe shoqata “Anibar” bashkuan burimet e tyre për të siguruar mjetet dhe intervenimin në objekt. Falë një nisme për donacione online në dhjetor të vitit 2018, janë grumbulluar 35% (EUR 8,750) të shpenzimeve nga vlera totale e projektit për rikonstruktim.

Një shembull interesant doli nga partneriteti i vazhdueshëm midis Shoqatës së Pensionistëve Serb-Australian, seksioni Ura Humanitare i mediumit online Vesti dhe kuzhina publike e shoqatës “Majka devet Jugovica” që ndodhet në Graçanicë - mes fushatave të shumta, njëra u përkushtua në mbledhjen e fondeve nga qytetarët me qëllim të furnizimit me ushqime elementare për përgatitjen e vakteve.

Përfundimisht, donacionet e masës individuale kanë ruajtur pozitën e tyre dominante në vitin 2018, gjithashtu falë iniciativës rinore në Prizren këtë Dhjetor. Iniciativa për mbledhjen e xhaketave u fillua nga Afrim Krasniqi dhe Getoar Besimi, për të ndihmuar fëmijët nga jetimoret dhe njerëzit në nevojë për kushte më të mira për të mbijetuar dimrin. Fushata arriti të fitojë interes të konsiderueshëm.

## **Kontributi individual**

Përveç donacioneve të shumta individuale, njerëzit nga Kosova dhe diaspora dhurojnë për të përmbushur nevojat e menjëherëshme të bashkëqytetarëve të tyre , nevojat humanitare dhe për trajtime medicinale të fëmijëve dhe të rriturve. Ja vlen të theksohen disa raste interesante të kontributit individual:

Autori kosovar Ramadan Mehmeti donoi bibliotekën e tij personale prej 3,200 librash për Bibliotekën e Gjilanit – Fan Noli. Majlinda Kelmendi – kampione e botës në Xhudo dhuroi një numër të caktuar të medaljeve të saj për organizatën Kujdesi për Fëmijët e Kosovës. Medaljet do të shiten dhe fondet e mbledhura do të përdoren për trajtimin mjekësor të fëmijëve me kancer.

## **Mbështetja nga diaspora**

Një e treta e të gjitha rasteve të donacionit, dhe një e pesta nga vlera totale vijnë nga diaspora. Një nga shembujt e shkëlqyeshëm të kontributit individual nga diaspora vjen nga Arsim Tahirsylaj dhe familja e tij nga Deçani që jetojnë tani në Austri. Familja donoi EUR 17,000 për ndërtimin e një shtëpie për familjen Kaçorraj nga fshati Lluka në Deçan. Arsim Tahirsylaj është i mirënjohur për dhënien e bamirësisë në rajon dhe me rastin e festës së Bajramit ai vendosi të ndihmojë këtë familje të pastrehë.

Përderisa të shumtat e rasteve të donacionit nga diaspora vijnë nga donatorë individual nga diaspora, shembuj domethënës janë evidentuar edhe në fushata të masës individuale. Një shembull i mbështetjes së tillë vjen nga një grup njerëzish që jetojnë në Zvicër, të cilët e vërejtën gjendjen e vështirë të familjes në nevojë ekonomike në Prishtinë. Shuma prej EUR 38,000 që u grumbulluan në ngjarjen humanitare “Ndihmo edhe ti” u dërguan për projektin e ndërtimit i cili shërbeu për strehimin e familjes. Një nismë e ngjashme, megjithëse e regjistruar më formalisht, përfshiu Forumin e Grave Shqipëtare në botë që grumbulloi EUR 12,000 dhe ia dërgoi Shoqatës Feniks në Ferizaj e cila filloi një projekt për strehimin e një individi në nevojë. Vetë Forumi është përfshirë në disa fusha përgjatë viteve, kësaj rradhe duke donuar EUR 8,000 (të mbledhura në një ngjarje në Zyrin) për njerëz me nevoja ekonomike në Kosovë.

Në mars të vitit 2018, Universiteti Amerikan i Kosovës mbajti një event në Nju Jork – për mbledhjene fondeve për studentët me nevoja ekonomike, i quajtur “Mbështet një Student”. Në këtë event ku mori pjesë komuniteti Shqipëtar i Shteteve të Bashkuara, arritën të grumbullojnë më shumë se EUR 36,000 për mbështetje me bursa për studentët të shquar që kanë vështirësi ekonomike dhe nuk mund ti financojnë studimet e tyre.


# Temat kyçe

**25.9%** lehtësimi i varfërisë/zvogëlimi

**25.9%** shëndetësor

**21.8%** arsimi  
mbështetja e grupeve të

**15.1%** marginalizuara



**5-10%** -

**3-5%** dhënia sezonale, kulturë dhe art

**1-3%** mjedis

**0-1%** mirëqenia e kafshëve, infrastruktura publike, sport

## Temat kyçe (në % të rasteve)

Tema	2016		2017		2018
Lehtësimi i varfërisë/zvogëlimi	37.1%	↗	46.7%	↘	25.9%
Shëndetësia	16.4%	↘	13.7%	↗	25.9%
Arsimi	10.2%	↻	10.0%	↗	21.8%
Mbështetja e grupeve të marginalizuara	19.9%	↘	13.3%	↗	15.1%

## Pikat kyçe


Katër temat kyçe të mbështetura ishin: lehtësimi i varfërisë dhe shëndetësia në nivel të barabartë, më pas arsimi dhe së fundi mbështetja e grupeve të marginalizuara. Përqindja e drejtuar kah këto tema shton deri në 88.7% raste të regjistruara.

Pozicionim i temave ka ndryshuar pak nëse e krahasojmë me vitin 2018 dhe viteve paraprake, megjithatë pavarësisht nga rënia e konsiderueshme të numrit të rasteve të donacionit, lehtësimi i varfërisë vazhdoi të jetë tema më e mbështetur – njerëzit me nevoja ekonomike ishin kategoria më e heshtur nga të gjithë grupet përfituese, nga të cilat projektet individuale për strehim morën vëmendjen më të madhe.

Falë sektorit jo fitimprurës i cili u aktivizua në mbledhjen e fondeve me qëllim që jo vetëm të sigurojë mbështetje strategjike për institucionet e përkujdesit shëndetësor por gjithashtu edhe për trajtimet mjekësore, kjo temë ka tërhequr vëmendje dukshëm më të fortë. Së fundmi (goxha pozitivisht), arsimi, si gjithmonë një temë më pak e mbështetur, këtë vit pati një rritje: donacione më të shpeshta u janë dedikuar institucioneve edukative dhe për bursa.

Vargu i temave tjera të mbështetura përbëhet nga gjashtë kategori, ndër të cilat është mirëqenia e kafshëve, mjedisi dhe dhënia sezonale. Dhënia sezonale si temë, gjithmonë ka paraqitur së paku një mbështetje në periudha të caktuara, dhe këtë vit është zvogëluar duke përfshirë 4.1% të të gjitha rasteve. Këtë vit nuk janë regjistruar raste të mbështetjes të drejtave të njeriut, manaxhimit të emergjencave, aktivitete religjioze dhe sipërmarrësi sociale

# Pranuesit






## Subjektet përfituese (% e rasteve)

	2016		2017		2018
Individët/familjet	67.8%	↓	63.3%	↓	57.8%
Organizatave jo fitimprurëse	12.3%	↑	23.0%	↓	19.8%
Institucionet	18.2%	↓	11.8%	↑	17.4%
Qeveritë lokale/qendrore	0.8%	↔	1.0%	↑	3.2%

## Pikat kyçe

Në vitin 2018 renditja e pranuesve qëndron në nivelin e njëjtë si në vitin paraprak. Individët dhe familjet kryesojnë pranuesit me një rënie të vogël në rastet e donacionit (57.8%). Raporti i mbështetjes së organizatave jo fitimprurëse ka pësuar poashtu rënie, përderisa institucionet kanë pranuar mbështetje më të shpeshtë në krahasim me vitin e kaluar. Një përqindje disi më e lartë e rasteve të donacionit janë drejtuar për qeveritë lokale dhe kombëtare. Mbështetja e grumbulluar për institucionet dhe qeveritë lokale dhe kombëtare (d.m.th. mbështetja për shtetin) ka qenë e regjistruar në 20.6% të të gjitha rasteve të donacionit, e cila paraqet një rritje të konsiderueshme nga viti 2017, por një nivel i ngjashëm është vërejtur edhe në vitet e mëparëshme. Mbështetja e tillë më e shpeshtë kryesisht është dedikuar kah institucionet edukative dhe shëndetësore, dhe në disa raste përmes punës së sektorit jo fitimprurës, i cili në mënyrë aktive kryesoi në grumbullimin e fondeve për të siguruar mbështetje afatgjate për kujdesin shëndetësor.

# Organizatat jo fitimprurëse në vitin 2018



## Pikat kyçe

Kategoria e organizatave jo fitimprurëse përbëhet nga shoqatat e shoqërisë civile, organizata të huaja si UNICEF dhe fondacionet private.

Dhurimi për organizatat jo fitimprurëse ka ardhur duke u rritur gradualisht deri në vitin 2018, kur u zvogëluar në 19.8% të rasteve të regjistruara. Duke pasur parasysh trendin një vjeçar, ne besojmë se kjo ulje mund të mos ketë ndonjë domethënie dhe mund të jetë vetëm përfaqësuese e një luhatjeje aktuale.

Nëse shikojmë profilin e donatorëve për organizatat jo fitimprurëse, trendi kryesor nga viti 2017 është vazhduar edhe në vitin 2018: rastet e shumta të donacionit për organizatat jo fitimprurëse ishin nga qytetarët - 29.4%. Kjo paraqet një mbështetje të zvogëluar që nga viti i kaluar, i cili rast paraqitet gjithashtu edhe me donatorët individual të cilët sipas përqindjes rënditen në rradhë të dytë. Në fakt donatorët individual dhe korporatat e ndajnë pozicionin, ku sektori korporativ ruajti nivelin e vitit 2017 për shpeshësinë e dhënies në organizatat jo fitimprurëse.

Temat që më shpesh janë mbështetur nga organizatat jo fitimprurëse kanë qenë mbështetja e grupeve të marginalizuara (me 44.1%) dhe shëndetësia (me 25%), që të dyja më të forta se në fitin 2017 (shëndetësia në veçanti me një rritje prej 17%) dhe lehtësimi i varfërisë (me një rënie të konsiderueshme prej rreth 26%). Për shkak të punës më të fortë dhe më të strukturuar të disa organizatave jo fitimprurëse përmes nismave dhe fushatave të ndryshme, fokusi i interesit të tyre u orientua nga lehtësimi i varfërisë (e cila ishte tema e parë në renditjen e vitit 2017) kah shëndetësia. Kjo u shpreh përmes përpjekjeve për të siguruar mbështetje afatgjate për institucionet shëndetësore si dhe trajtimin mjekësor të njerëzve me probleme shëndetësore. Tema tjera të mbështetura në masë më të vogël nga puna e organizatave jo fitimprurëse janë: arsimi, kultura dhe arti, dhënia sezonale, sporti dhe mirëqenia e kafshëve. Nuk janë mbështetur aq shumë tema si në vitin e kaluar, dhe lista e temave të regjistruara është më e shkurtër. Sipërmarrësia sociale dhe udhëheqja me emergjencat mungojnë.

Për sa i përket grupeve përfituese përfundimtare, vargu përfshin njerëzit në nevojë ekonomike dhe njerëzit me aftësi të kufizuara – secila kategori me 23.5% të rasteve të donacionit; më pas njerëzit me probleme shëndetësore, fëmijët pa përkujdes prindëror dhe komunitetet lokale paraqiten si të mbështetura më shpesh. Kategori tjera të rëndësishme që janë mbështetur më pak janë gratë dhe fëmijët të mbijetuar nga dhuna, komunitetet e pakicës, rinia e talentuar dhe gjithashtu kafshët.

## **Fushata të sukseshme**

Disa organizata jo fitimprurëse janë paraqitur në më shumë raste se tjerat. Organizatat jo fitimprurëse që kanë marrë donacione të shumta ishin shoqata të vendit që kanë marr mbështetje edhe vitin e kaluar: shoqata "Të veprojmë për Nënat dhe Fëmijët", "Majka devet Jugovića" dhe Fshatrat për Fëmijë SOS Kosovë. Fondacioni privat "Ti je një Luledielli", ngajshëm ka marrë një sasi të konsiderueshme të mbështetjes.

Disa organizata jo fitimprurëse ishin shumë aktive në mbledhjen e fondeve për shëndetësi në vitin 2018, e cila si temë pati një rritje në mbështetje. Një shembull i shkëlqyeshëm i theksuar edhe më parë i udhëhequr nga fondacioni "Ti je një Luledielli", me qëllim kryesor të mbledhë fonde për pajisje të shtrejta mjekësore. Kjo nismë është rajonale dhe u organizua edhe në Shqipëri dhe Maqedoni, përderisa fondet e grumbulluara në Kosovë përmes bluzave, u donuan për blerjen e pajisjeve të posaçme diagnostikuese për Departamentin e Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, që do të përdoret për trajtimin mjekësor të fëmijëve. Kjo fushatë mori mbështetje nga sektori korporativ dhe qytetarët të cilët kontribuan në mënyrë bujare, por gjithashtu gjeti mbështetje nga të famshmit dhe figurat publike të cilët e promovuan nismën. Bluzat e njohura që kjo organizatë filloi ti shesë në mars të vitit 2018.

Cikli Kosova për Fëmijë është një ngjarje për mbledhjen e fondeve , që filloi në vitin 2014, në bashkëpunim me shoqatën "Të veprojmë për Nënat dhe Fëmijët". Që atëherë, një grup prej 40 – 50 çiklistësh marrin pjesë në një turn vjetor, duke çikluar nëpër Kosovë, kalojnë nëpër qytetet kryesore të vendit, ku përfshihet 500km të çiklimit dhe 6,000 metro të ngjitjes. Turni vazhdoi në vitin 2015, 2016 dhe 2017 me qëllimin e njejtë, gjegjësisht mbledhja e fondeve për institucionet shëndetësore dhe secilin vit ngjarja arriti të grumbullonte nga 8 dhe 14,000 EUR, përmes sponsorizimit të korporatave, donacioneve individuale dhe evente për përfundimin e turnit të organizuara në Prishtinë. Në vitin 2018 eventit grumbulloi rreth EUR 7,000.

# Përfituesit

**30.8%** njerëzit në nevojë ekonomike

**24.4%** komunitetet lokale  
njerëzit me probleme

**19.8%** shëndetësore  
personat me aftësi të

**8.1%** kufizuara


tjera

**5-10%** -

**3-5%** njerëz që jetojnë në shtete tjera

**1-3%** nëna dhe foshnja, fëmijë pa përkujdes prindëror,  
rinia e talentuar, popullsia e përgjithshme

**0-1%** të moshuarit, prindër beqarë, të papunët, gra  
dhe fëmijë të mbijetuar nga dhuna, bashkësi  
fetare, popullsi të pakicave, kafshët



## Trendet në grupet kyçe të përfituesve përfundimtar (% e rasteve)

	2016		2017		2018
Njerëz në nevojë ekonomike	41.8%	↗	56.0%	↘	30.8%
Komunitetet lokale	14.5%	↔	14.3%	↗	24.4%
Njerëz me probleme shëndetësore	12.5%	↘	8.5%	↗	19.8%
Njerëz me aftësi të kufizuara	7.4%	↘	4.8%	↗	8.1%

### Pikat kyçe


Katër grupet kryesore të përfituesve përfundimtarë kanë qenë njerëzit në nevojë ekonomike, komunitetet lokale, njerëzit me probleme shëndetësore dhe njerëzit me aftësi të kufizuara, që përbëjnë më shumë se 83% të të gjitha dhurimeve në vitin 2018. Renditja mbetet e njëjtë si në vitet e kaluara.

Të gjitha kategoritë kryesore, përveç njerëzve në nevojë ekonomike, shënuan një rritje të konsiderueshme në rastet e donacionit të alokuara këtë vit. Si kategori, njerëzit në nevojë ekonomike kanë përjetuar një ngjitje prej 56% në vitin 2017, vetëm për të rënë në 30.8% në vitin 2018. Rënia e interesit të donatorëve për varfërinë dhe për njerëzit në rrezik ekonomik ka qenë e ndikuar në mënyrë direkte nga mbështetja shumë më e lartë për njerëzit me probleme shëndetësore dhe shëndetësinë në përgjithësi.

Duke pasur varfërinë si një nga problemet kryesore në shoqërinë Kosovare, njerëzit në nevojë ekonomike vazhdojnë të jenë grupi mbizotërues i përfituesve përfundimtarë në Kosovë. Faktorët ekonomikë dhe shoqërorë ndikuan në shoqëri në një mënyrë që, ashtu si vitet e kaluara, strehimi individual është akoma një nga nevojat kryesore për një popullatë të prekur ekonomikisht.

Një pamje pak më e ndryshme ëshë sa i përket grupeve përfituese të mbështetura më pak: shumica e kategorive që janë paraqitur në vitet paraprake mbeten prezente, me dy kategori më pak këtë vit – njerëzit e pastrehë dhe fëmijët dhe rinia në rrezik.

# Përdorimi i donacioneve



## Përdorimi i donacioneve (% e rasteve)

	2016		2017		2018
Mbështetje e njëherëshme	73.6%	~	73.3%	~	56.1%
Mbështetje afatgjate	18.4%	~	19.0%	~	35.5%
Të panjohur	8.0%	~	7.7%	~	8.4%

### Pikat kyçe

Edhe pse shpërndarja e përgjithshme qëndron në kufijtë dhe renditjet e njejta, dallimi është shumë pozitiv. Që d.m.th. mbështetja strategjike (mbështetje që do të prodhojë rezultate afatgjate: investime kapitale, paisje, bursa, shërbime dhe ngritja e vetëdijes) është rritur nga 19% prej rasteve të regjistruara në vitin e kaluar në 35.5% këtë vit. Megjithatë mbështetja e njëherëshme mbetet një kategori mbizotëruese (një rënie në vitin 2018), kjo është regjistruar si një tendencë e konsiderueshme sepse mbështetja afatgjate, si një kategori e dukshme e qëllimeve të ndryshme strategjike nuk ka pësuar rënie që nga viti 2013. Ky është gjithashtu një trend pozitiv për shkak të jetëgjatësisë së projekteve dhe larmisë së grupeve përfituese të mbështetura. Përkundër nevojave ekzistuese dhe dëshirës së donatorëve për të targetuar probleme shumë specifike dhe të menjëherëshme, është shumë inkurajuese që ato më së shpeshti vendosin të ofrojnë ndihmë strategjike. Këtë vit kjo është shprehur veçanërisht përmes interesit të rritur në shëndetësi dhe sigurimin e paisjeve për institucionet shëndetësore, por gjithashtu edhe përmes mbështetjes me bursa: të dhënat tregojnë se shëndetësia dhe arsimi janë ngjitur lartë sa i përket shpeshësisë së mbështetjes.

Mbështetja strategjike kryesisht jepet nga sektori korporativ – më shumë se gjysmat e rasteve të donacioneve të dhëna në formë të mbështetjes strategjike vijnë nga kompanitë dhe NVMtë. Nëse e shohim në aspekt të vlerave, përqindja është edhe më e lartë, pasi 74.9% e vlerës totale të donuar nga sektori korporativ i takon kategorisë së dhënies afatgjate.

Për shkak të mungesës së informacionit lidhur me disa raste të donacionit përdorimi i tyre nuk ishte e mundur të përcaktohet dhe përqindja e këtyre rasteve në vitin 2018 ruajti nivelin nga viti i kaluar – ky raport kryesisht luhet rreth 8% pas rënies nga kulmi i regjistruar prej 12% në vitin 2014.



## **Shembuj të mbështetjes afatgjate**

Në formë të granteve të vogla, Fondacioni Sunny Hill dhuroi gjithsej EUR 100,000 për 17 shoqata, fondacione dhe institucioneve për qëllime të ndryshme. Ndër të tjerash, disa shkolla muzikore dhe festivale kulturore dhe muzikore morën këto fonde si mbështetje institucionale për aktivitetet e tyre dhe përmirësimin e programeve arsimore, si dhe organizata të tjera që ofrojnë shërbime sociale për përfituesit e tyre. Një nga shoqatat që përfitoi është 'Fondacioni Kosova Së Bashku' qëllimi i së cilës është t'iu sigurojë fëmijëve dhe të rinjve mbështetje psiko-sociale dhe mbështetje emocionale përmes konsultimeve falas dhe promovimit të shëndetit mendor.

Coca Cola HBC filloi një fushatë me moton "Mëso, Praktiko, Vepra" e cila synon të ndihmojë të rinjtë të cilët janë të papunë duke ju mundësuar atyre trajnim dhe mentorim; duke përmirësuar njohuritë e tyre dhe duke fituar aftësi shtesë, ata do të jenë në pozitë më të favorshme gjatë kërkimit të punësimit. Ndërkohë që për pjesëmarrësit u organizua një trajnim 3 ditor për aftësi të ndryshme biznesore, Coca Cola ka lansuar thirrjen e dytë për të rinj prej 18 deri 30 vjeç, të marrin pjesë në ciklin e dytë të trajnimeve.

Një ndërmarrje e vogël dhe e mesme Tali prej Gjilani dhuroi një autoambulancë për spitalin rajonal në Gjilan. Kjo do të mundësojë që pacientët të transportohen më shpejtë dhe në një mënyrë më të sigurtë.



*Hulumtimi Kosova Dhuron 2018 Raporti Vjetor për Gjendjen e Filantropisë – Fakte të Shpejta është pjesë e një nisme më të gjerë për të promovuar dhe nxitur filantropinë një rajonin që përfshin Fondacioni Catalyst. Hulumtimi themelor dhe ky publikim janë krijuar nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkan) si dhe me mbështetjen bujare të Fondacionit C. S. Mott.*

*Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Besimi i Balkanit për Demokraci, Fondi Marshall Gjerman i Shteteve të Bashkuara, ose partnerëve të tij.*



---

**Catalyst Balkans**  
38 Takovska, Beograd

[catalystbalkans.org](http://catalystbalkans.org)  
[givingbalkans.org](http://givingbalkans.org)

**Përgatitur nga**  
Tomas Bueno Momčilović  
Jelena Bekčić

**Redaktuar nga**  
Aleksandra Vesić  
Simy Mathews

Beograd, 2019

**Të dhënat e mbledhura nga**  
Judita Krasniqi

**Dizajni**  
Luka Koković

**Përkthim**  
Adelina Ajdari